

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët” nr. 601, datë 04.09.2019, Urdhërit të Kryeministrit nr.38 datë 18.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët” si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

PASQYRA E PUNËS

POZICIONI I PUNËS	Specialist Kërkues Shkencor
DEPARTAMENTI	Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve
ADRESA E QSPA	Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, nr. 7/4, Tiranë
RAPORTON TEK	Drejtori i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve

PËRSHKRIMI I PUNËS (DREJTORIA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE)

Objekti i punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Konceptimi, organizimi dhe realizimi i kërkimeve dhe studimeve të thelluara në lëmitë e ndryshme të spektrit arbëresh;
- Zhvillimi i projekteve që hyjnë në fushën e veprimit të QSPA-së, duke mobilizuar e bashkërenduar burime njerëzore dhe materiale brenda dhe jashtë QSPA-së;
- Nxjtja e këtyre kërkimeve nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave, takimeve, apo eventeve;
- Valorizimi i rezultatit të këtyre aktiviteteve nëpërmjet publikimeve dhe akteve të tjera njohëse dhe promovuese.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Kryen studime themelore në fushën e tij/saj të specialitetit, e cila është një nga disiplinat, apo një kombinim i disiplinave të shkencave sociale të aplikuara mbi komunitetet arbëreshe si:

- **Gjuhësi;**

Shkruan dhe publikon, në suportet e QSPA-së si faqja web dhe suporte të tjera të komunikimit elektronik, botimet e QSPA-së, aktivitetet, shtypin periodik të QSPA-së, etj.

Merr pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencorë, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim.

- Të jetë i aftë të realizojë, përveç kërkimit shkencor në disiplinën përkatëse, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do t'i caktohen nga eprorët sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive;

EDUKIMI DHE TRAINIMET

Edukimi dhe eksperiencia që kërkojmë:

- Të zotërojë grada/tituj shkencore në fushën e Gjuhësisë. (Parapëlqehet të ketë përvojë në kërkime shkencore që prekin fushën e dialektologjisë);
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në fushën për të cilën punësohet;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor dhe botime në disiplinën përkatëse;
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj, minimumi niveli C1 (Italisht/Anglisht ose një gjuhë tjetër europiane).

AFTËSITË

- Aftësi vendimmarrëse dhe interpretuese
- Aftësi pune në grup
- Komunikim shumë i mirë
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion

KUSHTET E PUNËS

MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambjentet e përshtatshme dhe të mirëorganizuar për punën kërkimore e studimore.

ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16.30.

Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës.
2. Jetëshkrim (CV) në formatin Euro Pass.
3. Fotokopje të diplomave universitare dhe të gradës “Doktor”
4. Referencë nga të paktën një profesor
5. Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë.
6. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.
7. Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 07/07/2022 ora 14:00, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në rrugën “Ibrahim Rugova”, pallatit “Sky Tower”, kati i shtatë, ap. 4, si dhe në adresën e e-mail: info@qspa.gov.al

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) do të shpallë fituesin faqen zyrtare të institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail)